

**A kam të drejtë të kërkoj trajtim urgjent të kërkesës sime për qasje, nëse dokumenti që unë e kërkoj është i nevojshëm për mbrojtjen e jetës apo lirisë së dikujt?**

*Kur dokumenti publik i kërkuar, i cili në bazë të një vlerësimi të arsyeshëm shihet të jetë i nevojshëm për mbrojtjen e jetës apo lirisë së një personi, institucioni publik detyrohet të të ofrojë përgjigje brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve.*

**Në çfarë formash mund të kërkoj qasje?**

*Ti ke të drejtë të kërkoksh:*

- *kopjen e saktë në formë të shtypur ose tjetër të dokumenteve publike të kërkuara;*
- *mundësinë për shikim të dokumenteve publike, kurdo që është e mundshme përmes përdorimit të pajisjeve të vet institucionit;*
- *mundësinë për të kopjuar dokumentet publike, përmes pajisjeve tua;*
- *transkriptin e shkruar të fjalëve të përmbajtura në formë audio ose vizuele nëse ekziston apo rrjedh nga një takim i hapur;*
- *transkriptin e përmbajtjes së një incizimi, në formë të shtypur, audio ose vizuele, në rastet kur një transkript i tillë ekziston, duke përdorur pajisjet, të cilat janë përgjithësisht të qasshme për institucionin publik.*

**Si të veproj nëse Agjencia për Informim dhe Privatësi refuzon ankesën time?**

*Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesshëm të ankesës nga ana e Agjencisë, ti mund t'i drejtohesh me padi gjykatës kompetente për çështje administrative brenda tridhjetë (30) ditëve prej ditës së pranimit të vendimit përfundimtar nga Agjencia.*



AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI  
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST  
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI  
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST  
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



**Zyra për Komunikim me Publikun**

038 200 62 959

Adresa: Rr. 'Luan Haradinaj' Nr.36  
10000 Prishtinë

Info.AIP@rks-gov.net  
Ankesa.AIP@rks-gov.net

<http://aip.rks-gov.net/>

## **BROSHURË INFORMATIVE**

lidhur me të drejtat e qytetarëve që burojnë nga  
LIGJI NR. 06/L-081

## **PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE**



**Çka më garanton ky ligj?**

*"Të drejtën për qasje në dokumente publike të prodhurara nga institucionet publike."*

*„Të drejtën për ripërdorim të informatave të sektorit publik“*

Qasja në dokumente publike gjithnjë lejohet për dokumente lidhur me:

- shpenzime publike
- zbatimin e funksionit publik
- mjedisin

E drejta për qasje në dokumente mund të ju kufizohet vetëm nëse informata e kërkuar do të rrezikonte:

- shëndetin
- sigurinë publike
- hetimin e veprave penale
- hetimin disiplinor
- informata të klasifikuara
- të dhëna personale
- pronësi intelektuale

Në cilat institucione kam të drejtë të paraqes kërkesë për qasje në dokumente publike?

- në qeverinë dhe administratën e nivelit qendror dhe lokal;
- te personat fizikë apo juridikë, nëse ushtrojnë autoritet apo kompetenca administrative dhe vetëm në lidhje me to, kryejnë detyra publike, apo operojnë me fonde publike;
- në institucionet ligjvënëse (lidhur me aktivitetet e tyre);
- në institucionet e prokurorisë (lidhur me aktivitetet e tyre);
- në institucionet gjyqësore (lidhur me aktivitetet e tyre);
- në institucionet e pavarura;
- në subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, të cilat financohen me fonde publike;
- në kompanitë publike në të cilat shteti zotëron shumicën e aksioneve, apo të cilat ushtrojnë një funksion publik;

Çka konsiderohet 'dokument publik'?

*Çdo akt, fakt apo informatë në formë elektronike apo me zë, formë të shtypur, në incizime vizuale apo audiovizuale të prodhuara apo mbajtura nga institucioni publik*

Ku mund të ankohe nëse institucioni publik nuk më ofron qasje në dokumentin e kërkuar?

*Në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, përmes:  
038 200 62 959  
Rr. 'Luan Haradinaj', nr.36, Prishtinë  
info.aip@rks-gov.net / ankohu.aip@rks-gov.net*

Si mund të paraqes ankesë?

*Ti mund të ankohe me shkrim, në formë elektronike, ose verbalisht*

**MOS HARRO!**

*Çdo institucion publik ka të caktuar një zyrtar/e të posaçëm për pranimin dhe regjistrimin e kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike, për kryerjen e shqyrtimit fillestar të këtyre kërkesave, për ruajtjen dhe mbajtjen e evidencave të këtyre kërkesave dhe për raportimin rreth këtyre kërkesave.*

Kush vendosë për kërkesën time brenda institucionit publik?

*Zyrtari përgjegjës, i cili është zyrtari më i lartë administrativ në institucionin publik.*

Sa ka afat institucioni publik për të më kthyer përgjigje?

*Institucioni publik detyrohet që brenda shtatë (7) ditëve prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të nxjerrë vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë apo të pjesshëm, duke të informuar për të drejtën që ti ke për të kërkuar rishqyrtimin e kërkesës si dhe kur dhe ku të paraqitet kërkesa e tillë.*